TURGUT ÖZAL
INSTITUCIONET ARSIMORE
Durrës

Kolegji TURGUT ÖZAL

BULETIN

Nr. 8 / Prill 2018



"Një fillim i mbarë
për një të ardhme të sigurt"



- **Siguri**
- **Disiplinë**
- **Staf me përvojë**
- **Arsim në anglisht**
- **Transport i garantuar**
- **Ushqim i kontrolluar**
- **Aktivitete sportive e sociale**
- **Mundësi akomodimi në konvikt**
- **Metoda e kushte bashkëkohore**
- **Asistencë për studim jashtë vendit**

TURGUT ÖZAL
INSTITUCIONET
ARSIMORE
Durrës

Redaksia:

Fiqerete Hoxha
Lumturie Gjura
Suada Kroi
Entela Quku
Elsona Okshtuni
Julisjana Veliaj
Joana Petushi
Iris Gica
Jovan Shandro

Fotograf

Arlind Jeminaj

Design

Aldo Rrodostani

Përmbajtja



KOPSHT
9-VJEÇARE
E MESME

4- PROGRAMI I ORIENTIMIT 2017 - 2018
5- FILLIMI I SHKOLLËS
6- MUAJI I ARTIT DHE LETËRSISË
7- TAKIM ME SHKRIMTARË
8- ARBEN DERHEMI
9- INTERVISTA (ARBEN DERHEMI)
10- FINALJA ART-LETËRSI
11- KLUBI "SHPRESA"
12- PANAIRI USHQIMOR
13- ZGJEDHJET PËR PRESIDENTIN E SHKOLLËS
14- BINJAKËZIMI
15- KATEDRA NË SHKOLLË
16- FESTA E 28-29 NËNTORIT
17- MUAJI I HISTORISË DHE GJEOGRAFISË
18- ARTI SKENIK
19- PANAIRI I LIBRIT
20- TAKIM ME ISH - MATURANTËT
21- KONKURSI I PREZANTIMIT
22- SEMINARE TË NDRYSHME
23- KLUBET
24/25- OLIMPIADA
26- ESKURSIONE TË NDRYSHME
27- TAKIM ME PRINDËR
28- 7-8 MARSI
29- UROJMË 7-8 MARSIN INSTITUCIONEVE TË QYTETIT TONË
30- QËNDRA E TË MOSHUARVE
31- LIBRI I NËNËS
32- SEMINAR
33- VIZITË NË FABRIKËN COCA COLA
34- VIZITA NË BIZNESET E PRINDËRVE TANË
35- CEREMONIA E DIPLOMIMIT TË MATURËS 2017
36- MUAJI I ANGLISHTES
37- ASEF 2018
38- KAMPIONATI I SHAHUT
39- LUAJMË DHE VALLËZOJMË
40- KONKURSI SHKENCOR
41- MBJELLJA E PEMËVE
42- KET-PET dhe APTIS
43- LOJËRAT E INTELIGJENCËS
44- EKSKURSION NË VALBONË
45- BORË NË SHKOLLËN TONË
46- EGMO 2018
47-JBMO DHE BMO 2018

Kontakte

Adresa: Lagja 14. Mbikalimi i Shkozetit Durrës - Shqipëri
Mobile: +355 69 74 99 292
Web: durres.turgutozal.edu.al
E-mail: infodurres@turgutozal.edu.al
Facebook: turgutozaldurresofficial
Instagram: turgutozal_collegedurres

Për reklamimin e produkteve dhe shërbimeve tuaja në buletin tonë, kontaktoni nëpërmjet postës elektronike.

PROGRAMI I ORIENTIMIT 2017 - 2018

Startoi programi i orientimit për vitin 2017 -2018 në shkollën tonë. Nxënësve të rinj që kanë zgjedhur të studiojnë në kolegjin "Turgut Özal", u jepet mundësia të njihen paraprakisht me gjithçka që u ofron kjo shkollë. Qëllimi kryesor i këtij programi është aftësimi në lëndët e gjuhëve të huaja, duke parë në ç'nivel janë dhe punojnë në këto lëndë që të mos kenë diferenca me nxënësit ekzistues (theksojmë se gjuhët e huaja janë prioritet dhe nxënësit që kanë ndjekur ciklin 9-vjeçar kanë njohuri shumë të mira). Natyrisht janë mësuesit e anglishtes dhe të turqishtes, të cilët me përvojën, profesionalizmin dhe përkushtimin e tyre kanë hartuar materiale të veçanta për t'u ardhur në ndihmë sa më mirë këtyre nxënësve të rinj. Mësimi është kryesori për ta e nga ana tjetër përveç tij, ata kanë mundësi të prekin më nga afër mjediset e shkollës, në të cilën do të mësojnë në vazhdim, mjediset e konviktit, në të cilin do të jetojnë e patjetër që në momentin e parë që kanë ardhur janë bërë edhe pjesë e mensës së shkollës.



Ata janë prezantuar në një farë mënyre me ato çfarë mund të konsumojnë gjatë vitit shkollor. Nuk kanë munguar edhe aktivitetet argëtuese, në mënyrë që të ndihen sa më mirë këtu dhe ta kalojnë sa më lehtshëm largimin nga shtëpitë e tyre. Këta nxënës kanë ardhur nga çdo cep i Shqipërisë. "Kësaj shkolle i kemi besuar të ardhmen tonë,"-shprehen ata. "Jemi shkëputur nga një familje dhe kemi ardhur në prehërin e një familjeje më të madhe"- shtojnë më tej."Nuk është vetëm një shkollë e re kjo ku do të studiojmë, por edhe një jetë e re".



Në mbyllje veçojmë fjalët e Amarildos: " Prapa atyre godinave të mëdha ndodhet një zemër akoma më e madhe që e bën më ndjellëse dëshirën për të nxënë, pikësynimet më të mëdha dhe arritjet po ashtu".



FILLIMI I SHKOLLËS





Të qeshura, gëzim e hare. Vetëm këto fjalë mund të përshkruajnë më së miri atmosferën që mbizotëronte në ambientet e shkollës "Turgut Özal" ditën e parë të shkollës.Tre muaj pushime u dukën thjesht si tre ditë. Gjithçka ishte gati, laboratoret, klasat, kinematë, ambientet sportive ishin pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme në mënyrë që mësimi,olimpiadat, kampionatet, konkurset, dramat, festat të zhvilloheshin më mirë se kurrë më parë. Emocionet shpaloseshin qartë në fytyrat e femijëve të kopshtit dhe fillores, të cilët mezi prisnin të takoheshin me mësuesen dhe shokët e tyre dhe me padurim prisnin të fillonin një vit tjetër të mbushur me ekskursione, lojëra me njeri- tjetrin, aktivitete me artistët e cirkut, sigurisht të rrethuar me përkujdesje dhe dashuri nga edukatoret dhe mësueset e tyre. Nxënësit e 9-vjeçares nuk mbeteshin pas. Ata takoheshin me njeri-tjetrin dhe me humor kujtonin kohët e kaluara së bashku jo vetëm gjatë orëve të mësimit,por sidomos kohën që kishin kaluar në klubet e kompjuterit, pikturës, muzikës apo kërcimit. Për nxënësit që uleshin për herë të parë në bankat e kësaj shkolle, fillimi ishte i mbushur sa me ankth , aq dhe me optimizëm për gjithçka që ata do të mësonin dhe kujtimet që do të krijonin. Gjimnazi i tejmbushur me nxënës të rinj e të vjetër në sytë e të cilëve dallohej qartë kureshtja për sfidat që do të sillte ky vit i ri shkollor duke e ditur se në krah do të kishin mësuesit, të cilët do t'i motivonin e ndihmonin në vështirësitë që do të hasnin. Fillimi i shkollës shihej me entuziazëm dhe optimizëm nga të gjithë: qofshin këta mësues, nxënës, të cilët me bashkëpunimin e tyre do të vazhdonin traditën duke krijuar ardhmërinë dhe duke inspiruar njëri-tjetrin për të punuar e për të thyer limitet. Buzëqeshja ishte kryefjala e asaj dite.

MUAJI I ARTIT DHE LETËRSISË

Në shekuj letërsia dhe arti janë në qendër të vëmendjes së njeriut. Me anë të leximit jo vetëm sodisim botën me fantazi, por edhe njohim të kaluarën për t'u përballur me të ardhmen. Leximi i letërsisë së mirë, është jo vetëm një përvojë me vlerë, por është një nevojë që na mëson me veprimet, ëndrrat, fantazitë, marrëdhëniet me të tjerët, me anën sekrete të ndërgjegjes sonë e patjetër një portë , një dritare që sjell dritë në botën e kulturës. Kjo sillet nga magjia e artit dhe e letërsisë. Në proçesin mësimor – edukativ nga pjesmarrja e nxënësve dallohet një numër i tyre me prirje në fushën e krijimtarisë me imagjinaë , kureshtje të pazakontë e ndjesi estetike që vlerësojnë të bukurën duke e kërkuar atë . Këta nxënës përbëjnë një vazhdimësi për përtëritjen dhe fuqizimin e botës intelektuale dhe shpirtërore të vendit. Mbështetje për përpjekjet për këtë fuqi krijuese me natyrën e tyre origjinale e shije të shëndosha. Faqet e këtij buletini e pasqyrojnë më së miri frymëzimin, zbulimet, format sa më të reja dhe të papërsëritshme në vazhdimësinë e aktiviteteve të ndryshme që shkolla zhvillon. Eshtë më se e natyrshme që letërsia dhe arti të ketë një vend nderi krahas aktiviteteve të tjera.













TAKIM ME SHKRIMTARË

Shkolla është cilësuar si vatra e dijes. Një burim i pashterur i njohurive të marra në fusha të ndryshme të artit. Një ndër këto është edhe libri si miku më i afërt i nxënësve. Pikërisht për të krijuar një lidhje të fortë midis tyre, në shkollën tonë në kuader të muajit të letërsisë ishin të ftuar dy shkrimtarë të njohur të qytetit të Durrësit, Z. Vasillaq Papaj dhe Znj. Gladiola Busulla. Ky takim u organizua nga vetë nxënësit e shkollës, të cilët interpretuan pjesë nga krijimtaria e dy shkrimtarëve, por jo vetëm… Ata kishin përgatitur edhe disa pyetje të cilat ishin të përqëndruara kryesisht në poezitë e përzgjedhura nga vetë ata. Ky afrim i ngrohtë, miqësor dhe edukues i nxënësit me shkrimtarin ka si synim të rrisë dëshirën e tyre për të qenë më pranë librit…











ARBEN DERHEMI

"Rrno për me tregue", monodrama e regjizorit Milto Kutali,interpretuar nga aktori i shquar Arben Derhemi u shfaq përpara artdashësve të kolegjit "Turgut Özal" Durrës. Një monodramë e mbushur me dhimbje, vuajtje e vërtetësi pa fund. Pasqyrë e një realiteti të hidhur jo vetëm për Atë Zef Pllumin, por edhe për të burgosurit e tjerë në kohën e diktaturës. Nëpërmjet kësaj monodrame, edhe nxënësit sikur e prekën nga afër tmerrin e kaluar në ato vite, aq më tepër nga ai interpretim i mrekullueshëm, drithërues që i mbajti jo pak, por gjashtëdhjetë minuta të mbërthyer me vëmendje maksimale.



Intervista

Ishte vetë dëshirë e juaja që të hynit në botën e artit , apo ndikuan dhe prindërit tuaj në këtë zgjedhje?

- Ishte thjesht dëshira ime , prindërit nuk kanë ndikuar fare. Im atë donte që edhe unë si ai, të bëhesha operator dhe si çdo prind donte që të më kishte sa më pranë.
Në Akademinë e Arteve përfundova pothuajse rastësisht , por dalëngadalë fillova të mendoja se kisha një lloj talenti në këtë fushë dhe kam përshtypjen se nuk kam gabuar. Vetëm se duhet një vëmendje dhe një punë e jashtëzakonshme.

Siç e dimë , familja , në çdo zgjidhje që bën fëmija e tyre , do ta mbështesë. A keni patur shtysa të tjera krahas familjes? A ka pasur shoqëria juaj ndikim të fortë?

- Normalisht të gjithë personat që kam pasur pranë , jo vetëm familja por edhe shoqëria ime, kanë ndikuar te unë me kritikat dhe me qëndrimet e tyre , përsa i përket vështirësive që unë kam pasur pasi zgjodha këtë profesion. Por edhe njerëzit me të cilët takohem përditë , njerëz të cilët të falin kënaqësi kur je mes tyre, më bëjnë shumë të gëzuar që ushtroj këtë profesion.

Krahas punës së palodhur personale dhe orëve të tëra të kaluara duke ushtruar, a mendoni se edhe fati ju ka ndihmuar disi për të arritur këtu ku jeni sot?

- Të them të drejtën nuk e di se sa ka qenë fati me mua , por nëse fat quhet që skenaristë shumë të njohur të shkruajnë vepra që përshtaten me karakterin tënd dhe ti interpretosh ti , atëherë unë kam pasur shumë fat. Më shumë se kaq nuk besoj t'më ketë ndihmuar fati . Megjithatë e kemi kërkuar shumë dhe vazhdojmë ta kërkojmë . Gjithshtu nuk mund të mos përmend dhe mbështetësit tanë privatë të cilët na mbështesin pa na njohur dhe pa interes, pasi ne nuk bëjmë publicitet me shfaqjet tona . Ata na kanë ndihmuar pasi janë njerëz që mendojnë ndryshe, ashtu si duhet të mendojnë të gjithë në lidhje me artin.

Diçka që të bën përshtypje është fakti se shumica prej nesh pavarësisht se kënaqemi shumë kur shohim produktin final të punës suaj , nuk e perceptojmë se si realizohet ai , se çfarë vështirësish hasen gjatë përgatitjes së tij. A mund të na tregoni disa nga këto vështirësi?

- Është shumë i vërtetë fakti që ka shumë vështirësi. Për përgatitjen e veprës " Rrno vetëm për me tregue" kemi harxhuar rreth tre muaj e gjysëm kohë dhe kemi shkuar vetë në një vend ku ka jetuar At Zef Pllumi. Kjo vizitë na ndihmoi shumë , sidomos në aspektin emocional . Gjithashtu duke folur me fretërit , mësuam se At Zef Pllumi ishte një njeri fare normal, madje thuhej se ishte shumë me zevzek se shumica e njerëzve që unë kam takuar ne jetën time. Nuk ishte një nga ata njerëz që ne i portretizojmë si mite , por ishte një njeri krejt normal që nuk i duronte dot padrejtësitë. Madje unë jam i mendimit se njerëzit normal janë ata që bëjnë ndryshime.

Si ka ndikuar kjo kohë e gjatë e kushtuar aktrimit në jetën familjare? A ka qenë e vështirë t'i koordinoni këto të dyja?

- Njeriu kur do e gjen mundësinë për çdo gjë , madje sipas meje është më mirë kur ka dy punë se sa kur nuk ka asnjë. Edhe unë edhe Mirko kemi dy familje të cilave i kushtojmë një vëmendje të veçantë dhe një kohë shumë të madhe . Po të dojë njeriu bën gjithçka , mjafton dëshira . Unë kam një vajzë që nuk e ka ndjerë kurrë mungesën e babait të saj sepse pavarësisht vështirësive ,arrij të gjej kohën për gjithçka . Në fund të fundit, ç'kuptim ka jeta nëse nuk "shijon" as fëmijën tënd ?!

Çfarë këshille do t'i jepnit të gjithë të rinjve të cilët duan të ndjekin rrugën që keni zgjedhur ju ?

- Do t'u thoja që nëse aktrimi është vërtetë ajo cfarë ata duan , ta ndjekin këtë ëndërr pavarësisht vështirësive të shumta që mund të hasin, të mos dorëzohen përpara asgjëje .

Si ju dukëm ne nxënësit e kolegjit gjatë shfaqjes dhe bashkëbisedimit që realizuam me ju?

- Mund të them sinqerisht se ju keni qenë një ndër audiencat që na keni dhënë më shumë kënaqësi , me më shumë vëmendje dhe dëshirë për të dëgjuar, si dhe padyshim jam ndjerë shumë herë më rehat me pyetjet tuaja gjatë bashkëbisedimit, se sa në shumë intervista që kam dhënë në televizionet shqiptare. Ndjeva jashtëzakonisht shumë kënaqësi që ndava ato çfarë kam kaluar dhe këshillat e mia me ju.

FINALJA ART-LETËRSI

Kjo Finale e Madhe, paraprihet nga konkurset reciproke të zhvilluara në secilën shkollë dhe një punë përgatitore dhe të përkushtuar, si prej nxënësve ashtu dhe prej mësuesve. Vlerësimi i nxënësve konkurentë bëhet nga një juri profesioniste për secilën fushë. Gjatë gjithë aktivitetit emocionet ishin të pranishme kudo, si te konkurrentët dhe te juria, por momenti më emocionues i këtij aktiviteti ishte momenti i ndarjes së çmimeve dhe i dhënies së medaljeve nxënësve fitues. Urojmë suksese të mëtejshme në vitet që vijojnë, për të gjithë nxënësit pjesëmarrës në këtë konkurs!















KLUBI "SHPRESA"

Klubi "Shpresa" ka vite që është ngritur nga nxënësit e shkollës sonë me qëllimin për t'u ardhur në ndihmë njerëzve në nevojë. Ky klub vazhdon të mbledhë ndihma dhe t'i shpërndajë ato në familje me probleme ekonomike. Ndër aktivitetet e këtij klubi përmendim: bashkëpunimin me Shoqatën e Fëmijëve Jetimë, bashkëpunimin me DAR Durrës dhe ndihmat në ushqime e veshje për familjet e prekura nga përmbytjet. Një nismë e re këtë vit ka qenë prezantimi i temave që prekin shoqërinë ku jetojnë.











PANAIRI USHQIMOR

Si pjesë e klubit "Shpresa" është dhe panairi ushqimor që tashmë është kthyer në traditë të përvitshme. Të gjithë nxënësit e shkollës duke filluar nga më të vegjlit e kopshtit e deri te nxënësit maturantë morën pjesë në panair për të qenë sa më pranë moshatarëve dhe familjeve në vështirësi ekonomike.
Ky aktivitet u mbyll me panairin e mësuesve të shkollës . Të ardhurat e këtij panairi u bënë pjesë e aktiviteteve të klubit "Shpresa" për të falur akoma dhe më shumë dashuri dhe buzëqeshje.











ZGJEDHJET PËR PRESIDENTIN E SHKOLLËS



Si çdo vit tjetër në shkollën tonë, pas zgjedhjeve të senatorëve, më datë 18 tetor u organizuan zgjedhjet për presidentin e qeverisë së nxënësve. Katër kandidatët e dalë nga senati prezantuan në sallën e konferencave përballë nxënësve të gjimnazit platformën e tyre. Dëshira për t'u bërë zëri i shkollës shihej në fytyrat plot emocion të konkurrentëve. Fjalimet kishin veçoritë e tyre çka i bënte ato të spikatnin e të merrnin votën.

I pari u prezantua Amardo Osmani, nxënës i klasës së 11-të. Tek ai shihej serioziteti, përkushtimi dhe toni bindës për atë çfarë mendonte të realizonte. Një aspekt tjetër që ia vlen të përmendet nga premtimet e tij ishte mbarëvajtja e marrëdhënieve dhe bashkëpunimi midis nxënësve, mësuesve dhe prindërve. Kandidatja e dytë ishte Eldisa Qoku nxënëse e klasës së 12-të, e cila me fjalimin e saj iu drejtua bashkëmoshatarëve thjesht, por me emocion dhe vendosmëri me moton:" Bashkimi bën fuqinë". Eldisa u premtoi dëgjuesve të saj se nëse do ta votonin nuk do të pendoheshin pasi ajo tashmë e kishte vërtetuar në tri vite që dinte t'i kthente fjalët në vepra. Kandidatja pasuese, Ira Teqja spikati për figuracionin e pasur në fjalimin e saj dhe sigurisht prekte interesat më të mprehta të nxënësve si: hartimi i një menuje të re ushqimi dhe përdorimin e pajisjeve elektronike. Fjalimi i fundit, por jo më pak i rëndësishmi ishte ai i Redi Muharremit. Redi kishte hartuar një plan tepër të detajuar ,i cili përfshinte interesat dhe nevojat e çdo grupi nxënësish. Ai premtoi dhe fitoi votën e shumicës. Secili bëri zgjedhjen që mendoi si më të mirën dhe s'na mbetet gjë tjetër veçse t'i urojmë suksese të mëtejshme presidentit në zbatimin e planit të tij.



Amardo Osmani



Eldisa Qoku



Ira Teqja



Redi Muharremi

BINJAKËZIMI



Një klimë e mirë pune e krijuar tashmë ndër vite midis kolegjit "Turgut Özal" Durrës dhe shkollës fillore "25 Maji" Hasanbeg – Shkup ishte dhe takimi radhës më 23. 10 2017. Përvoja të reja, këmbim idesh e sjellë kjo me anë të një vizioni të ri në artin e të qenurit mësimdhënës në arsimimin dhe edukimin e brezave të rinj. Realizuar me vizita në orë mësimi në kolegj në lëndët Edukim fizik, Anglisht dhe Matematikë. Ky binjakëzim në dobi të të gjithëve si për mësuesit dhe nxënësit sjell shkëmbime e perfomanca të reja, të ndryshme midis dy shkollave mike për të vetmin qëllim në zhvillimin e gjeneratës së re me risit e bashkëpunime, shoqëri të reja e përvoja të mbetura gjatë në kujtesë me vlerë edukim, arsim për të ardhmen. Duke uruar suksese dhe sfiduar me të reja bashkëpunime në punën që na pret, me shumë dashamirësi jeni të mirëpritur në kolegjin tonë, e patjetër bashkëpunimi vazhdon.









KATEDRA NË SHKOLLË



Mësimdhënia e sukseshme është një nga sfidat më parësore në kolegjin "Turgut Özal' Si në proçesin e marrjes së njohurive shkencore, por edhe përgatitja e denjë për qytetarët e së nesërmes. Kjo nismë si çdo vit shkollor mblodhi bashkë anëtarët e katedrave të ndarë sipas profileve lëndore. Në qendër të diskutimeve vëmendja përqendrohet te përdorimi i metodave të ndryshme të mësimdhënies, dëshira për të tërhequr nxënësit pranë dijes, aktivizimi në punë të pavarur e kërkimore për të zbuluar të reja e zgjidhur probleme, përbën gjithmonë e më shumë një betejë që kërkon bashkëpunimin e të gjithëve dhe si rezultat arritjet e tregojnë më së miri me përvojën e krijuar. Duke qenë të njëmendë me tematika të ndryshme se si suksesi te jetë primar secila katedër brenda në shkollë zhvillon punën e saj çdo muaj duke nxjerrë në pah bashkëpunimin ndërmjet kolegësh për të vetmin qëllim: Brezat e së ardhmes të sfidojnë në fusha të ndryshme me projekte, konkurse, aktivitete të ndryshme, shkencë, edukim, kulturë, emancipim, progres, humanizëm, ky është qëllimi dhe detyra e të gjithëve për të ardhmen që na pret.







FESTA E 28-29 NËNTORIT

Ky vit ishte tepër i veçantë për të gjithë shqiptarët....sepse u cilësua viti i Skënderbeut, heroit tonë kombëtar. Si në çdo institucion edhe në shkollën tonë, muaji nëntor ishte pikërisht muaji kur iu thurën lavde, u respektua dhe u nderua si kurrë ndonjëherë **Gjergj Kastriot Skënderbeu** por jo vetëm... Nxënësit recituan vargje në nder të tij dhe luftëtarëve të tjerë, kënduan dhe kërcyen me melodítë popullore e tradicionale shqiptare duke përkujtuar edhe këtë vit, si çdo vit tjetër të gjithë ata që ranë për liri. Nuk munguan pjesët dramatike të interpretuara nga vetë nxënësit dhe ajo çka është edhe më e rëndësishmja të ftuarit u bënë pjesë e aktivitetit duke përcjellë emocionet dhe mesazhet e tyre. Falendërojmë Z.Vasillaq Papaj dhe Z. Avni Çuni, të cilët kanë përkrahur dhe mbështeur nxënësit tanë në këtë aktivitet.















MUAJI I HISTORISË DHE GJEOGRAFISË

"Lirinë nuk ua solla unë, atë e gjeta këtu midis jush" me këto fjalë të Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kstriot Skënderbeut përshkruhet "Muaji e Historisë" që ndryshe nga vitet e mëparshme, këtë vit u fokusua më së shumti tek figura e Heroit tonë Kombëtar, në kuadër dhe të 550-vjetorit të vdekjes së tij. Një muaj që mbart krenari për të gjithë, një muaj që na kujton edhe më shumë vlerat e kombit tonë . Gjatë këtij muaji në kolegjin "Turgut Özal" nxënësit u sensibilizuan dhe u ndien më krenarë se kurrë, teksa zbukuronin me simbole të veçanta godinën dhe klasat e shkollës. Nuk munguan edhe konkurset ndërmjet klasave, ekskursionet si dhe vëzhgimi i dokumentarëve me karakter historik. Një falenderim i veçantë shkon për mësuesit dhe nxënësit që ishin pjesë aktive e organizimeve në këtë muaj. Edukimi me ndjenjën e atdhedashurisë është një nga prioritetet e shkollës sonë.









ARTI SKENIK









Gjatë muajit nëntor kulmuan aktivitete të shumta kulturore, letrare dhe historike.Një ndër to ishte dhe konkursi i përvitshëm i "Artit skenik" ndërtmjet kolegjeve. Kolegji "Turgut Ozal" Durrës ishte mikpritësi i grupeve të "Artit skenik" nga të gjitha shkollat. Emocionet ishin të forta, garimi ndërmjet tyre gjithashtu.Juria profesioniste vlerësoi talentin dhe përkushtimin e jashtëzakonshëm të nxënësve, të cilët sipas tyre shfaqën një lojë aktoriale si të ishin aktorë profesionistë.

Tri grupet e shkollës sonë na përfaqësuan denjësisht. Nxënësit e klasës XII, zunë vendin e tretë me interpretimin e monodramës "Apologjia e Sokratit".

PANAIRI I LIBRIT

Panairi i Librit është një ngjarje e rëndësishme kulturore ku paraqiten botimet më të mira të hedhura në qarkullim në harkun kohor të një viti, nëntor 2016-nëntor 2017. Ky panair bashkon të gjithë njerëzit që merren me letrat shqipe: autorët, botuesit, lexuesit, përkthyesit, përfaqësuesit e shtypit dhe të medias etj, me synimin për të krijuar e zhvilluar kontakte tradicionale midis tyre, duke synuar promovimin dhe nxitjen e leximit, veçanërisht te të rinjtë. Disa nga gjimnazistët e shkollës vizituan stendat e shtëpive botuese për t'u njohur me botimet e reja.



***

NOETIC LEARNING



Është fantastike të jesh i mirë në matematikë! Integrimi i nxënësve në botën e shkencës dhe matematikës arrihet nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. Nën moton "Është fantastike të jesh i mirë në matematikë" është zhvilluar Olimpiada Ndërkombëtare e Matematikës Noetic Learning, ku kanë marrë pjesë 25 000 nxënës nga e gjithë bota. Një përgatitje e veçantë, për Noetic Learning u bë edhe me nxënësit e shkollës sonë. Pjesëmarrës të kësaj veprimtarie ishin nxënësit e klasave 4 - 8. Në këtë olimpiadë nxënësit tanë u vlerësuan me çertifikata nderi dhe medalje. I falenderojmë nxënësit për punën e tyre dhe iu urojmë suksese të mëtejshme.

TAKIM ME ISH -MATURANTËT




Atmosfera e festave të fundvitit mblodhi në një takim ish-maturantët e kolegjit "Turgut Özal" Durrës, tashmë studentë, që studiojnë brenda dhe jashtë vendit, në degët e tyre të preferuara. Disa drejt përfundimit, të tjerë në vazhdim e më të shumtë rishtarët që dalëngadalë po i afroheshin sezonit të parë të provimeve. Interesante dhe shumë të ngrohta bisedat mes mjekëve, arkitektëve, ekonomistëve e inxhinierëve të ardhshëm.









KONKURSI I PREZANTIMIT

Konkursi i prezantimit këtë vit në shkollën tonë erdhi me risi në organizim. Të shumtë ishin nxënësit që morën pjesë në këtë konkurs, që me aftësitë e tyre përcollën tri temat e përzgjedhura: Bullizmi, Autizmi dhe Varfëria. Nuk mungonin talentet midis konkurrentëve. Nxënësit fitues të tri vendeve të para morën pjesë në finalen midis kolegjeve në Shkodër, ku e përfaqësuan denjësisht shkollën tonë duke fituar dy vende të treta, përkatësisht me nxënësit: Gjergji Llushkaj dhe Aurora Kapo. Më shumë se një konkurs prezantimi ai ishte një konkurs ndërgjegjësimi, në të cilin nxënësit me temat që zgjodhën dhe fjalimet që mbajtën pasqyruan bindjet më të thella dhe mesazhet më me vlerë që mbartin brenda tyre për njëri- tjetrin dhe shoqërinë tonë.



SEMINARE TË NDRYSHME




Ish kolegjisti i vitit të kaluar Barjol Lami i cili sot studion në një nga universitet më prestigjoze në botë (MIT) na vizitoi në shkollë ku dhe pati një bisedë të ngrohtë e miqësore me maturantët e këtij viti. Ai iu përgjigj pyetjeve të shumta të drejtuara prej tyre. Sa më shumë punë këmbëngulëse dhe vullnet për të përballuar sfida të mëdha - ishte mesazhi i Barjolit për bashkëmoshatarët. Dr.William Karl Martin nga California bëri një bashkëbisedim me nxënësit e klasës së 12-të me temë " Mendimi Kritik" (Critical Thinking). Ishte një eksperiencë e vyer për nxënësit tanë të cilët tashmë janë në hapat e fundit të përzgjedhjes së degës së tyre në universitet.

Po ashtu ish maturantja e shkëlqyer e shkollës sonë Era Psatha zhvilloi një bashkëbisedim me nxënësit e klasave të 10-ta për eksperiencat e saj të aplikimit dhe vazhdimit në universitete të ndryshme në Europë.











KLUBET



Misioni i një shkollë është të drejtojë nxënësit në rrugën e gjatë të dijes, t'i aftësojë ata në jetë dhe t'i ndihmojë në formimin e personalitetit që në moshë të hershme. Natyrisht për të arritur këtë synim duhen hapësirat e duhura ku fëmijët të shfaqin interesat dhe talentin e tyre. Për këtë arsye në shkollën tonë organizohen klube të fushave të ndryshme si: basketboll, shah, kërcim, piano, informatikë etj.





Janë vetë nxënësit ata që përzgjedhin lëndën ku dëshirojnë të marrin pjesë, duke u ndihmuar të zhvillojnë talentin dhe aftësitë e tyre individuale nën kujdesin e mësuesve dhe profesionistëve përkatës.

Rezultatet e arritura nga organizimi i këtyre klubeve kanë qenë gjithnjë e më tepër pozitive, duke na dhënë ne mundësi për hapjen e dyerve të reja në kërkim të formave bashkohore të edukimit.



TRADITA V

OLIMPIADA KO



Tradita vazhdon… Ky është një titull shkrimi i përvitshëm që nuk mungon asnjëherë në shkrimet e shkollës "Turgut Özal". Arsyeja e thjeshtë: fitues të rinj, nxënës të suksesshëm e rezultate për t'u admiruar në konkurrime të ndryshme. Ndër to veçojmë rezultatet e nxënësve olimpiadistë në lëndët që mësohen në shkollë.Fituesit e fazës së dytë ishin të shumtë. Spikatin veçanërisht fituesit e lëndëve shkencore, përkatësisht: 7 nxënës në lëndën e fizikës, 8 nxënës në lëndën e matematikës,15 nxënës në lëndën e kimisë dhe 17 nxënës në lëndën e biologjisë.

Në disa prej këtyre lëndëve është zhvilluar dhe faza e tretë (rangu kombëtar) e olimpiadave. Në aq sa janë zhvilluar sërish nxënësit tanë kanë korrur sukses. Në Olimpiadën Kombëtare të Matematikës zunë vende të dyta këta nxënës: Gred Braho klasa X, Majla Sulejmani klasa XI, Jovan Shandro klasa XII dhe vendin e parë e zuri Ana Radoniqi klasa IX. (Ana ishte e vetmja nxënëse në Shqipëri që zuri këtë vend). Po kështu vende të dyta zunë: Kristi Shaka klasa XI, në Olimpiadën Kombëtarte të Kimisë dhe Elma Maliqati klasa X, në Olimpiadën Kombëtare të Fizikës. Gjithashtu në Olimpiadën Kombëtarte të Biologjisë nxënësi Alfred Emiri klasa X, zuri vendin e parë, Amanda Dervishi klasa XI zuri vendin e dytë dhe Alba Myshketa klasa XII, vendin e dytë.

Ndërsa nxënësja Dhepina Peçini u vlerësua me medalje nderi në Olimpiadën Europiane të Matematikës për Femra "EGMO 2018".

Natyrisht që këto suksese kanë ardhur si rezultat i bashkërendimit dhe mbarëvajtjes së punës së palodhur, talentit, prirjes së vetë nxënësve, punës dhe përkushtimit të mësuesve dhe prindërve të tyre, si dhe mbështetjes së vazhdueshme që u ka dhënë drejtoria e shkollës "Turgut Özal" me vënien në dispozicion të orëve ekstra në mënyrë që të punohet më tej me programet përkatëse lëndore.

Siç kanë rezultuar deri tani, shpresojmë dhe urojmë që të vazhdojnë edhe në të ardhmen nxënësit e kësaj shkolle. Këta do të bëhen promotorë të zhvillimit të mëtejshëm të vendit dhe më gjerë.

AZHDON...

MBËTARE 2018



"Një fillim i mbarë për një të ardhme të sigurtë"

Nderi

2 Ari

7 Argjendi

TURGUT ÖZAL INSTITUCIONET ARSIMORE
Durrës

EKSKURSIONE TË NDRYSHME

Aktivitet edukative jashtëshkollore si ekskursionet, vizitat, ekspozitat etj, janë cilësuar si pjesë tepër e rëndësishme në ecurinë e një shkolle. Me qëllimin e rritjes së ndërgjegjësimit për rëndësinë e bukurisë natyrore dhe edukimin e nxënësve për të bukurën, për natyrën dhe historinë, shkolla ka organizuar shëtitje brenda dhe jashtë vendit. Përkatësisht nxënësit e shkollave të mesme kanë qenë në një vizitë turistike disa ditore në Itali dhe një grup nxënësish shkuan për të bërë ski në Maqedoni.



Po ashtu edhe nxënësit e shkollës 9-vjeçare kanë përzgjedhur Malin e Zi për të kaluar disa ditë të veçanta në shoqërinë e njëri-tjetrit dhe të mësuesëve njëkohësisht. Ndryshe nga këta, nxënësit e fillores kanë patur si destinacion të tyre Greqinë e përkatësisht Korfuzin si një vend të njohur për pasuritë gjeografike e historike. Ekskursionet jashtë vendit nuk kanë qenë të vetmet, që janë organizuar në shkollën tonë. Vizitat në qytete të ndryshme brenda Shqipërisë kanë synim të lejojnë nxënësit të prekin më nga afër pasuritë e vlerat e vendit tonë dhe këtë vit qyteti i Krujës, Shkodrës e shumë të tjerë kanë mirëpritur vizitorët e vegjël të shkollës "Turgut Özal" Durrës.

TAKIM ME PRINDËR

Prindërit kanë përgjegjësinë kryesore në edukimin e fëmijëve të tyre.Shkolla jonë respekton dhe vlerëson këtë rol të familjes dhe synon një bashkëpunim të vazhdueshëm me ata. Ne ofrojmë mundësinë e pjesëmarrjes aktive të prindërve në jetën e shkollës dhe dëshirojmë që së bashku të jemi pranë nxënësve. Takimet individuale me prindërit si dhe diskutimet e hapura me ta janë tepër të domosdoshme në marrëdhëniet shkollë-fëmijë.



7-8 MARSI

Muaji mars nis me dy festa të rëndësishme kushtuar dy prej njerëzve më me ndikim në jetën e çdo njeriu, mësuesit dhe nënës. Dashuria dhe nderimi për këto dy figura u përcoll përmes interpretimeve emocionuese në programin festiv të 7-8 Marsit të nxënësve të ciklit fillor dhe atij 9-vjeçar. Nuk mund të lëmë pa përmendur dhe më të vegjlit e shkollës që sollën hare dhe gëzim për mësuesit dhe familjet e tyre.

Këtë vit nxënësit nuk u mjaftuan vetëm me programin artistik, por zgjodhën të sjellin një dhuratë ndryshe. Ata hodhën mendimet dhe ndjenjat e tyre në letër, për figurën më të shtrenjtë "Nënën". Dedikimet e tyre ata i bashkuan dhe i botuan në librin " Nëna, etalon dashurie".



UROJMË 7-8 MARSIN
INSTITUCIONEVE TË QYTETIT TONË

Respekt dhe nder për ne t'u urojmë institucioneve vendore të qytetit tonë 7-8 Marsin.
Na shoqëron gjithmonë bashkëpunimi dhe respekti reciprok në marrëdhëniet tona institucionale.
Suksesi ynë ka qenë i mbështetur dhe i vlerësuar ndër vite nga këto institucione.
Kolegji ynë ndien vlerësim dhe obligim për të ardhmen.



QËNDRA E TË MOSHUARVE

Të edukojmë nxënësit tanë me ndjenjën e respektit për të moshuarit.
Vizitë në Rezidencën Ditore të të Moshuarve Durrës me rastin e 8-Marsit.









LIBRI I NËNËS











Në zemrën që merr flatra me anë të frymëzimit, molekula bëhet diell, kurse pika e ujit, det! Me rastin e festës së "8 Marsit" nxënësit e shkollës sonë hodhën mendimet dhe ndjenjat e tyre në letër për figurën më të shtrenjtë "Nënën".
Dedikimet e tyre ata i bashkuan dhe i botuan në librin "Nëna etalon dashurie". Gëzuar "8 Marsin" të gjitha nënave!
Pastë veç lumturi në zemrat e tyre!







SEMINAR

"Siguria dhe shëndeti në punë", janë një ndër masat kryesore të marra nga shkolla jonë. Ato kanë si synim përmirësimin e kushteve gjatë procesit të punës, ruajtjen e jetesës dhe integritetin e shëndetit të personelit dhe nxënësve tanë.

Në kuadër të bashkëpunimit me kompaninë TRAJF, i gjithë personeli i shkollës mori pjesë në seminarin e trajnimit për: kushtet e punës, higjenën, sigurinë e punonjësve dhe nxënësve si dhe rrezikshmëritë në punë. Përveç kësaj, u bë dhe trajnimi për mbrojtjen nga zjarri, i aksidenteve në punë, sëmundjeve të ndryshme, mënyra e përdorimit të ambjenteve dhe mjeteve të rrezikshme si dhe mirëmbajtja e tyre.

Një rëndësi e veçantë u tregua edhe për skemën e evakuimit në raste zjarri ku u shpjeguan me detaje informacione të rëndësishme të cilat u ilustruan edhe me video në sallën e konferencave.

Ky seminar u finalizua me këndin e sigurisë në punë dhe me trajnimin e personelit me çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri dhe evakuimin.







VIZITË NË FABRIKËN COCA COLA



Si çdo vit, shkolla jonë është e përkushtuar jo vetëm në mësimdhënien bashkëkohore brenda ambienteve të saj, por edhe në argëtimin e nxënësve duke pasur si qëllim gjithmonë edukimin e tyre dhe nxitjen për të qenë sa më praktikë në jetë. Nisur nga kjo, me nxënësit e klasave të gjashta u organizua një vizitë pranë kompanisë së prodhimit të pijeve Coca-Cola.



Nxënësit u njohën më nga afër me hapat që kompania ndjek për prodhimin e pijes më të dashur për ta, që nga përgatitja e formulës, tek sterilizimi i shisheve dhe kanaçeve të ambalazhit si dhe tek hapi përfundimtar: paketimi. Gjatë vizitës ata diskutuan me drejtuesit e kësaj kompanie ku shkëmbyen pyetje në lidhje me menaxhimin dhe suksesin e saj. Në fund shprehen kënaqësinë për të përsëritur një vizitë të tillë edhe në kompani të tjera të ngjashme.



VIZITA NË BIZNESET E PRINDËRVE TANË

Kolegji ynë krahas synimeve dhe objektivave arsimore, ka synim që të njohë nxënësit me bizneset e prindërve të tyre si dhe kontributin në ekonominë e qytetit.
Për këtë arsye shkolla organizon vizita në bizneset e prindërve ku nxënësit njihen nga afër me bizneset, profesionet, cilësinë, tregun dhe suksesin e biznesit të tyre. Biznese këto të cilat janë mbështetje dhe ndihmë edhe për nismat që shkolla jonë ndërmerr.

















CEREMONIA E DIPLOMIMIT TË MATURËS 2017

Mbrëmja e maturës, diplomimi… Dikur tingëllonin kaq të largëta e sot një ëndërr që u bë realitet, një ceremoni që lidhi së bashku zemra, lot e fjalë që do të ruhen gjatë në palimpsestin e mendjes e shpirtit tonë.

Së bashku kemi qeshur e kemi qarë, kemi ndarë shqetësimet e gëzimet tona, kemi mbështetur e frymëzuar njëri-tjetrin, kemi lozur e kemi punuar, por në këtë ditë të veçantë nga zemrat tona buruan veç urime të sinqerta për të ardhmen e cilitdo prej nesh, kudo ku fati ta kishte përcaktuar atë. U desh punë nga ana jonë e përkushtim nga ana e mësuesve për të arritur deri këtu, te numërimi mbrapsht njëzëri ,te hedhja e kapeleve të suksesit, për t'u hapur dyert me maturi përgjegjësive e arritjeve të reja në të ardhmen.

Jeta na përplas me sfida e pengesa, momente të bukura e të vështira, na ndan e na bashkon me njerëz që bëhen pjesë e këtij udhëtimi kaq unik e të papërsëritshëm. Ndonëse për shumë prej nesh kjo ceremoni, krahas kurorëzimit të suksesit e punës shumëvjeçare, ishte sinonim i ndarjes, ajo përsëri mbetet ndarja më e ëmbël dhe e ngrohtë, e cila pasohet nga malli i pashtershëm për ato çaste që nuk kthehen më.





MUAJI I ANGLISHTES

Komunikimi është thelbësor në të gjitha fushat e jetës, qoftë në politikë, arsim, mjekësi, transport, marketing etj. Duke pasur parasysh politikën, bizneset si dhe diplomacinë, lind nevoja e një lidhjeje midis kombeve dhe shteteve me njëra-tjetrën. Pa komunikimin e duhur, lidhja bëhet e paarritshme dhe e pamundur. Ura që lidh skajet e hendekut është padyshim gjuha angleze. Konkretisht, në kolegjin tonë anglishtja është një kriter që nxënësit duhet të plotësojnë. Synimi ynë është t'i motivojmë dhe t'i inkurajojmë nxënësit jo vetëm që t'i përmirësojnë aftësitë e tyre të të shprehurit, por edhe t'u japim zë ideve të tyre nëpërmjet aktiviteteve të zhvilluara gjatë muajit të anglishtes.

















ASEF 2018

Në Konkursin Shkencor dhe Social ASEF si çdo vit mori pjesë edhe shkolla jonë. Pas fazës së parë eleminatore, në fazën finale kaluan një numër i konsiderueshëm projektesh. Të gjithë nxënësit konkurrues u prezantuan denjësisht përmes projekteve dhe ideve mjaft të gjetura dhe një punë përgatitore disamujore. Anëtarët e jurisë shkonin në çdo stendë dhe nxënësit u shpjegonin projektin e tyre, duke folur për fazat përgatitore të projektit, duke shpjeguar me anë të broshurave të ndryshme dhe duke pasqyruar dhe projektin në fazën e tij përfundimtare. Prezantimi i gjithë projekteve bëhet në gjuhën angleze. Pasi u vlerësua secili prej projekteve, në fund të ditës u shpallën edhe fituesit e vendeve të para, të dyta dhe të treta, duke marrë medaljet dhe çertifikatat përkatëse.



KAMPIONATI I SHAHUT

Shkolla jonë pati kënaqësinë të mirëpriste shahistët e shkollave 9-vjeçare të qytetit të Durrësit, pjesmarrës në kampionatin e shahut të organizuar nga Federata Shqiptare e Shahut dhe Qendra Kulturore e Fëmijëve Durrës.













“LUAJMË DHE VALLËZOJMË”

Nxënës dhe mësues nga shtete të ndryshme,të veshur me kostumet tradicionale të vendeve të tyre vizituan sot shkollën “Turgut Özal” në Durrës. Ata do të marrin pjesë në aktivitetin e organizuar, nga Qendra Kulturore e Fëmijëve “Luajmë dhe vallëzojmë”.













KONKURSI SHKENCOR



Konkursi Shkencor 2018 u organizua për herë të 11-të nga kolegji "Turgut Özal", Durrës. Ky është një aktivitet në bashkëpunim më DAR-et e të gjitha qyteteve. Këtë vit kishte 202 nxënës pjesëmarrës nga 36 rrethe të ndryshme të Shqipërisë. Këta nxënës ishin të përzgjedhur nga drejtoritë dhe zyrat arsimore. Nxënësit pjesëmarrës kaluan 2 ditë në ambientet e shkollës sonë. Ata u testuan për njohuritë e tyre në lëndët shkencore dhe më pas për ta ishin organizuar aktivitete sociale dhe shëtitje. Ditën e dytë u zhvillua ceremonia e ndarjes së çmimeve sipas rezultateve të testimit. U dhanë 21 bursa studimi për nxënësit më të mirë, përkatësisht 50 % deri në100% bursë në të gjitha kolegjet "Turgut Özal" dhe "Gulistan". Gjithashtu shkollave nga të cilat vinin këta nxënës fitues iu dhanë dhurata simbolike për arritjet e nxënësve të tyre.









MBJELLJA E PEMËVE









Nxënësit e shkollës sonë iu bashkuan sot nismës së prefekturës së qytetit për mbjelljen e pemëve. Krijimi i mjediseve të gjelbra luan një rol të veçantë në shëndetin tonë dhe zbukurimin e mjedisit. "Kush mbjell një pemë sot, shpëton jetë ndër breza"

KET-PET dhe APTIS

Në kuadër të kontrollit dhe identifikimit të nivelit të gjuhës Angleze në kolegjin "Turgut Özal" Durrës u zhvilluan provimet Key English Test (KET) për klasat e 6-ta, APTIS për klasat e 7-ta dhe Preliminary English Test (PET) për klasat e 8-ta. Këto provime synojnë të testojnë nivelin e njohurive në gjuhën angleze të nxënësve në gramatikë, lexim, dëgjim dhe në të folur. Në fund të testimit nxënësit do të pajisen me çertifikata ndërkombëtare sipas niveleve përkatëse që do të arrijnë në këtë provim. Suksese!











LOJËRAT E INTELIGJENCËS

Ashtu si në çdo vit tjetër edhe këtë vit, shkolla "Turgut Özal"organizoi aktivitëtin e lojerave të inteligjences Në këto lloj lojërash synohet nxjerrja në pah e aftësive dhe e talenteve të nxënësve si: kreativiteti, shkathtësia etj. Shumëllojshmëria e lojërave, si: shahu,reverse, mangala, jenga, hanoli, 9-gurëshi, kakuzu dhe skrabble. Përveç ndjenjës së kënaqësië që sollën tek nxënësit pjesëmarrës, treguan dhe aftësitë zotëruese ndaj këtyre lojërave duke u bërë fitues të vendeve të para, të dyta dhe të treta siç tregohen më poshtë:















Sudoku:

Vendi i parë: Fabjen Taraj
Vendi i dytë: Klevisa Shkaba
Dejvi Koçilja
Vendi i tretë: Ingrid Mora
Ilvjo Bezati

IQ:

Vendi i parë: Imena Taka
Vendi i dytë: Jona Salobehaj
Vendi i tretë: Ona Selita
Dea Myshketa

Set Game:

Vendi i parë: Safiyye Sema Gök
Vendi i dytë: Melisa Kondi
Vendi i tretë: Glejdis Meminaj
Ajna Jashari

Konkursi midis klasave:

9C

Imena Taka
Ana Radoniqi
Esli Muharremi

8A

Nijada Kacmoli
Endri Turku
Jurgen Balliu

EKSKURSION NË VALBONË

Natyra shqiptare të fton në gjirin e saj për të dhuruar mbresa të paharruara, për t`i prekur, për t`i shijuar e pse jo qetësia që ofrohet duke qenë pranë saj, fton stafin e kolegjit "Turgut Özal" në një ditë tetori te nisej drejt Shipërisë Veriore në Valbonë. Peizazhi plot ngjyra, ajri i pastër, dielli që buzëqesh, mikpritja tepër bujare e jetës malësore që shikohet në detaje më të vogla për të ruajtur të paprekur trashëgiminë e të parëvë dhe kaluar në breza mori vëmendjen duke lënë përshtypje të paharruara. Forma të ndryshme të relievit të pikturuara me kujdes të jashtzakonshëm nga nëna natyrë të bën pjesë dhe nxit imagjinatën për t'u bërë të shpeshta këto udhëtime dhe pse jo mjaft çlodhëse që të dhurojnë plot ndjesi pozitive.





BORË NË SHKOLLËN TONË

Qyteti i Durrësit u gjend i veshur me petkun e bardhë të borës, fenomen ky i rrallë për këtë qytet. Efekti i borës ka ndikuar dhe tek nxënësit e shkollës sonë, të cilët të entuziazmuar nga bukuria e saj luajtën të gëzuar në oborrin e shkollës.



















EGMO 2018

Shkolla jonë mori pjesë me katër nxënëse në Testin e Matematikës e cila përzgjodhi nxënësen Dhespina Peçini e cila do të përfaqësojë Shqipërinë në Olimpiadën Europiane të Matematikës për femra, "EGMO". Urimet më të mira nxënëses dhe suksese të mëtejshme!



MAJLA SULEJMANI -11



JOANA PETUSHI -12



ROMELDA BLACËRI -12

DHESPINA PEÇINI -10

JBMO 2018

Nxënësja e shkollës sonë Ana Radoniqi klasa e IX është përzgjedhur për të përfaqësuar Shqipërinë në Olimpiadën Ballkanike të Matematikës për të rinj (JBMO 2018) që do të zhvillohet në Greqi.
I urojmë suksese!



BMO 2018

Nxënësit e shkollës sonë Romelda Blacëri dhe Redi Muharremi janë përzgjedhur për të përfaqësuar Shqipërinë në Olimpiadën Ballkanike të Matematikës, "BMO 2018".
Ju urojmë suksese!





HARMONIA
HOTELS GROUP

HOTEL
Albanian Star
CONFERENCE & BEACH RESORT

Horizont Hotel
SPA & WELLNESS CENTER

Sun Hotel

Dependance
Ibiza

Dependance
Akileda

CONTACT US

+355 52 262 240 +355 67 20 61 003 info@harmonia-hotels.com www.harmoniahotelsgroup.com

Str. Rruga e Kompleksit, km 3, Golem - Durrës